

VENDIM
Nr. 484, datë 24.7.2024

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS DHE TË NIVELEVE TË
PAGAVE TË POZICIONEVE “KOORDINATOR KUNDËR KORRUPSIONIT” NË
DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS SHETETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

a) institucione të administratës shtetërore në varësi të Kryeministrit apo të ministrave të linjës, ku, për efekt të këtij vendimi, bëjnë pjesë: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në nivel qendror e vendor, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Instituti i Shëndetit Publik, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave;

b) Institucione në nivel qendror të sistemit shëndetësor, ku, për efekt të këtij vendimi, bëjnë pjesë: Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Spitali Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Spitali Universitar i Traumës, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

2. Klasat e pagës dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet “Koordinator kundër korrupsionit”, në institucionet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore (paga për pozicion, shtesa për vjetërsi në punë dhe shtesa e nivelit të kualifikimit) për secilën klasë të përcaktuar në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe vlerat për secilin element janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

4. Paga bruto mujore për pozicionet “koordinator kundër korrupsionit”, në institucionet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit dhe shtesa për vjetërsi të përcaktuara në lidhjen nr. 2, të këtij vendimi, kanë të njëjtën vlerë dhe mënyrë llogaritjeje me atë të miratuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e personelit mjekësor dhe të punonjësve të tjerë më arsim të lartë në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2024, përballohen nga fondet buxhetore të miratuara dhe fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.

7. Koordinatorët e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore, që nuk janë më pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, deri në

ndërprerjen e marrëdhënies së tyre të punës, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 436, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”, do të vijojnë të përfitojnë pagën bruto mujore të përcaktuar në vendimin nr. 323, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave dhe të niveleve të pagave të pozicioneve ‘Koordinator të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit’ në disa institucione të administratës shtetërore”.

8. Vendimi nr. 323, datë 31.5.2023, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave dhe të niveleve të pagave të pozicioneve koordinator të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në disa institucione të administratës shtetërore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2024.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

Klasat e pagës dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet “koordinator kundër korrupsionit”, në institucionet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lekë/muaj)
Koordinator në: - Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.	I-4	1	18 000
Koordinator në: - Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; - Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.	II-1	1	15 000
Koordinator në: - Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit; - Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura; - Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.	II-1	1	10 000
Koordinator në: - Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; - Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural; - Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; - Drejtorinë Qendrore të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar; - Institutin e Shëndetit Publik; - Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor në nivel qendror; - Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial; - Shërbimin Social Shtetëror në nivel qendror; - Agjencinë e Trajtimit të Pronave.	II-1	1	5 000
- Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.	III-2	1	18 000
	IV-1		

Lidhja nr. 2

Paga bruto mujore për pozicionet “koordinator kundër korrupsionit”, në institucionet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi

Pozicioni	Paga bruto mujore		
	Grupi i diplomës	Shtesa për vjetërsi	Paga e pozicionit
Koordinator në: - Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.	1	2%	170 000
Koordinator në: - Spitalin Universitar të Traumës; - Qendrën Spitalore Rajonale, të Tiranës “Shefqet Ndroqi”.	1	2%	160 000
Koordinator në: - Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	1	2%	155 000
Koordinator në: - Spitalin Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”; - Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”.	1	2%	141 000